

Besim MUHADRI
GJEKË MARINAJ: POETI I SHQUAR I DIASPORËS SHQIPTARE
NË AMERIKË

Hyrje

Poeti, përkthyesi, kritiku letrar dhe profesori universitar, Gjekë Marinaj, prej vitesh jeton dhe vepron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai është themelues i shoqatës së shkrimtarëve shqiptaro-amerikanë në SHBA në vitin 2001 dhe ishte presidenti i parë i saj. Është autor i disa librave me poezi, i disa përkthimeve shumë të rëndësishme të autorëve të huaj e veçanërisht të atyre amerikanë.

Gjekë Marinaj është lindur në vitin 1965 në fshatin Brrut të komunës së Malësisë së Madhe. Në gusht të vitit 1990 ai botoi një poezi satirike me titullin “Kuajt”, e cila u cilësua si antikomuniste, ndërsa botimi i saj i solli telashe, madje edhe kërcënim për arrestim. Kjo poezi u bë edhe shkak i arratisjes së tij nga Shqipëria. Pas një qëndrimi në shtetin e atëhershëm jugosllav ai shkoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në qershor të vitit 1991 arriti në San Diego, kurse më pas në Richardson të Teksasit, ku kreu Shkencat e Përgjithshme (Associate in Science) në Brookhaven College. Marinaj i vazhdoi studimet në Universitetin e Teksasit në Dallas, ndërsa në vitin 2006 u diplomua në degën e Letërsisë Botërore. Këtu e mori gradën shkencore *Magna Cum Laude*. Po në këtë universitet (në shkenca letrare), ai kreu edhe studimet master dhe, më vonë, edhe ato të doktoraturës.

Që nga viti 2001, Gjeka është profesor i gjuhës dhe i komunikimeve angleze si dhe i letërsisë botërore në Richland College.

Vepra letrare:

Gjekë Marinaj i ka botuar përmbledhjet poetike: "Mos më ik larg" (1995), "Infinit" (2000) dhe "Lutje në ditën e tetë të javës" (2008), si dhe një numër të konsiderueshëm punimesh publicistike dhe kritikë letrare. E ka botuar librin me intervista autoriale "Ana tjetër e pasqyrës" (2003), librin me publicistikë "Ca gjëra nuk mund të mbeten sekret" si dhe një libër me kritikë letrare "Protonizmi: nga teoria në praktikë", i cili u cilësua si libri i pari i këtij lloji, ndërsa autori themelues i protonizmit^{xi}. Gjekë Marinaj është fitues i çmimit *Pjetër Arbërori* në letërsi, i akorduar nga QNK-ja, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në vitin 2008^{xi}, por edhe i një varg çmimesh të tjera.

Poezia “Kuajt” ose fillimi i triumfit poetik i Gjekë Marinajt

“Ka shumë mënyra për ta kuptuar botën. Mund të ketë mënyra logjike dhe bindëse, por ka edhe mënyra për ta provuar botën përmes metaforave poetike. Lexoni botën e rrezikuar dhe të rrezikshme të “Kuajve” nga Gjekë Marinaj...” – kështu e fillon shkrimin e saj prof. Koosul Kim-i nga Universiteti “Hyupsung”, shkrim në lidhje me poezinë *Kuajt*, i botuar në gazetën

koreane "Kyunggi"^{xi}. Historia e botimit të poezisë është sa interesante aq edhe e dhimbshme, me titullin domethënës "Kuajt" e poetit Gjekë Marinaj, djaloshit nga Malësia e Mbishkodrës, atëherë një gazetar lokal, por i njohur në fushën e poezisë. Ajo, përveç jehonës së madhe për mesazhin e saj, njëherësh poetit të ardhshëm ia ka shkaktuar edhe arratisjen e detyrueshme nga atdheu, por jo edhe nga poezia, e cila më vonë do t'i bëhej një nga bashkudhëtarët më të dashura dhe më jetëdhënëse^{xi}.

Poezia "Kuajt", siç u tha edhe në një rast, u botua më 19 gusht të vitit 1989, në gazetën "Drita", organ i atëhershëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe i artistëve të Shqipërisë. Poezia në fjalë shpaloste diçka më të thellë. Ajo trazoi blozën e zezë në arteriet e popullit që ishte akumuluar nga pakënaqësia dhe zemërimi gjysmëshekullor ndaj regjimit komunist, siç kishte ndodhur edhe me popujt e tjerë të Evropës Lindore. Gazeta *Drita* thuhet se është shitur në të gjithë vendin brenda disa orësh. Njerëzit e kopjuan poezinë nëpër copa letrash dhe ia shpërndanin fshehtas njëri-tjetrit kudo që ndodheshin. Muaj më vonë, gjatë demonstratave antiqeveritare, protestuesit nëpërmjet megafonave e recituan nëpër rrugë poezinë "Kuajt"^{xi}.

Kjo poezi e Gjekë Marinajt, me gjithsej 21 vargje, ku secili varg i saj ka një domethënie të caktuar, ndërlidhet me jetën, me punën dhe me fatin e njeriut shqiptar të asaj kohe, të mbyllur brenda konturave të një regjimi të egër dhe vrastar. Krahasimi me kuajt ose metafora krahasuese e kuajve me qeniet që i përngjanin njeriut është një simbolikë fatale dhe interesante meqë, përveç një poeti të talentuar, ajo paralajmëronte edhe një përmbysje mentalitetesh artistike të strukura brenda një cikli të pakuptimshëm jete.

*Tërë jetën duke vrapuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s' duam t'ia dimë.*

Siç shihet, tri vargjet e para shpërfaqin imazhin e qenies së shndërruar në mosqenie ose në një makinë pune që nuk ka emër të përveçëm, që nuk ka ndjenja. Në një qenie të dëgjueshme që zbaton vetëm urdhra pa pasur të drejtë ose guxim e forcë kundërshtimi. Këtë e shohim edhe në vargjet në vazhdim:

*Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim;
Heshtim,
Dëgjojmë;
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,*

Ndërkaq, vargjet përmbyllëse tregojnë përmasën e mentalitetit ose të aftësisë receptuese, përkatësisht të fuqisë së perceptimit dhe të fatit të qenies. Kjo është ana tragjike dhe fatale e qenies që ka humbur sensin e kundërshtimit, por jo edhe atë të servilitetit e të frikës. Asaj i

mungon iniciativa për të kundërshtuar që nënkupton edhe topitjen fatkobe të mendjes që, njëkohësisht, reflekton edhe me topitjen e guximit, të mendjes dhe të reflektimit në situatë.

Asnjë nga ne s'është mendjehollë.

Kush qe kalë mbreti,

Posti qe i lartë

Kush qe kalë princeshe

I bënë shalë të artë

Kush qe kalë fshatari

Pati samarë me kashtë

Kush qe kalë i egër

Tërë jetën fjeti jashtë...

Poezia e Marinajt – poezi e shkrirjes së biografisë së autorit me biografinë e qenies

Poezia e Gjekë Marinajt karakterizohet nga një shkrirje ose bashkëdyzim i biografisë së autorit me biografinë e qenies. Kjo nënkupton edhe ndërlidhjen e autorit me atdheun dhe qenien e tij. Të dyja, bashkë edhe me talentin dhe pasionin, janë çelësi i suksesit dhe i rrugëtimit krijues të një poeti.

Nëse marrim për analizë librin e tij “Lutje në ditën e tetë të javës”^{xi}, i cili hapet me ciklin “Mesnatë pa kalendar”, shohim se poezitë e këtij cikli, ashtu sikurse edhe pjesa dërrmuese e poezive të Marinajt “përbëjnë një rifreskim fundamental të poezisë bashkëkohore, me një përkushtim substancial të poetit plot çiltërsi metafore dhe shpirt të gjerë komunikimi”^{xi}. Por, poezia e Marinajt ka edhe formën tradicionale. Të shkruarit, mbase për një masë më të gjerë lexuesish, herë-herë ngjan me poezinë e Lasgush Poradecit, veçmas me distikun e tij karakteristik, por edhe për nga përsosuria dhe aspekti ritmik i saj.

Poezia e Marinajt, në përgjithësi, është poezi brenda së cilës shpërfaqen pasazhe drithëruese, meditative. Gjatë leximit të saj, lexuesi sikur e qetëson shpirtin përmes imazhesh poetike që lëvizin me lirshmëri. Ato janë disa poezi për fshatin, vendlindjen, Nënë etj. (te cikli “Në duart e nënës”). Ndërkaq, poezitë e ciklit “Rrëfimi i Rozafës”, ku autori i këndon Shkodrës, Kosovës, Rozafës, Nënë Terezës, Skënderbeut etj., janë poezi të cilat shpërfaqin dashurinë humane, jo erotike:

Nën iluzionin se një grua vlen më pak se një burrë,

Më murosën mua.

...

Nën pretekstin se te gjithë patën të drejtë,

Edhe unë murosë brenda vetes fjalën “orasje”.

(Rrëfimi i Rozafës)

Ndërkaq, poezitë e ciklit “Sugjerim me zë të ulët” janë poezi që brenda vetes bartin disfatat njerëzore dhe vështirësitë e njeriut në jetë. Ato përcjellin njëkohësisht mesazhin e qartë të përballimit të sfidave të jetës.

Cikli poetik “Ailurovoja në gjyqin e fjalës”, është një cikël me poezi kushtuar poetëve, Vilson Blloshmit dhe Gjenc Lekës, jeta e të cilëve u takon realiteteve të ndryshme, të mbushura me vuajtje ose lavdi. Përveç poezive dhe dedikimit për poetët e pushkatuar nga regjimi më 1977, aty shohim edhe poetin tonë kombëtar, Gjergj Fishtë, të mohuar për pesëdhjetë vjet me radhë e prapë të ripranuar, pastaj tragjizmin e poetit fatkeq por shumë të talentuar, Frederik Rreshpjes etj.:

*“Poetit i pati humbur me kohë harmonia e trupit
Me ndjenjën. Koordinimi i shpirtit me vargun jo.”*

Poezia e Gjekë Marinajt, qoftë ajo e përmbledhur në këtë libër ose qoftë edhe ajo si tërësi, është një poezi që shënon një pikë kthese në poezinë shqipe. “Ajo është një lëndë universale plot trazim shpirtëror, dijes, kulturash dhe emocioneve të thella. Ato kanë një dendësi artistike, forcë dhe imazhe që shkojnë nga ato të drejtpërdrejta deri te surrealistet. Ajo është një dëshmi poetike për njerëzimin, i cili ka akoma shumë sfida dhe punë për të bërë, duke bartur ideale të forta të jetës dhe të lirisë^{xi}.”

Në poezinë e Marinajt, qoftë te ky libër ose edhe te librat e tjerë ku “është shkrirë një pjesë e biografisë së tij në biografinë e qenies”^{xi}, qenie e cila paraqitet e përcaktuar, autori “ka lënë një hapësirë që t’ia mundësonte lexuesit identifikimin e mesazhit dhe të perceptimit të vargut.”^{xi}

Duhet thënë se poezia e Marinajt është një poezi me vlera të theksuara dhe të dëshiruara poetike. Ajo është një poezi “e pajisur” me një figuracion të mjaftueshëm stilistik dhe e dominuar nga një frazë e zgjedhur poetike, stil letrar magjepsës, ruajtje me fanatizëm të vazhdimësisë së poezisë së mirëfilltë letrare”^{xi}.

Poezia e Gjekë Marinajt dhe mendimi kritik

Duke qenë një poet i rëndësishëm, por edhe një studiues i zellshëm i letërsisë botërore, poeti shqiptaro-amerikan, Gjekë Marinaj, ka marrë cilësimet nga më të mirat e mundshme nga ana e kritikës letrare, si nga studiuesit shqiptarë, ashtu edhe nga ata të huaj, veçmas atyre amerikanë, ku është integruar plotësisht, natyrshëm dhe me shumë sukses. Ai është cilësuar si “një poet universal, brenda të cilit shkrihen dijenia e jetës dhe e artit, të cilat të dyja bashkë japin pamjen më të përkryer të krijimtarisë. Por, edhe si një poet i cili “po sfidon emrat më të mëdhenj të poezisë bashkëkohore amerikane, duke tronditur formalitetin poetik dhe format tradicionale të shkruarit”^{xi}. Duke pasur parasysh edhe meritat dhe atributet e tjera, ai u quajt “më tepër se poet”^{xi}, ndërkaq poezia e tij u cilësua si një poezi mjaft autentike, mishërim i invencionit, i mundësive të pafundme të sintezave asociative; poezi e gërshetimit të nuancave të ndryshme të shprehurit, me elementet diskursive dhe imagjinatën e frytshme e të paanë^{xi}.

Vlerësime për poezinë e Marinajt, kanë dhënë: Senada Demushi, studiuese nga Shkodra, Ismail Kadare, Fatmir Terziu, Ndue Ukaj, Mujo Buçpapaj, Adnan Mehmeti, Prend Buzhala, Shefqet Dibrani, Ilir Seci, Mimoza Rexhëvelaj, Mikel Gojani, Anton Goçaj, Kujtim Morina, Ragip Sylja e të tjerë. Ndërkaq, nga autorët e huaj, për poezinë e Marinajt, kanë shkruar: shkrimtari amerikan, Fridrik Turner, shkrimtari Wole Souinka, fitues i çmimit “Nobel” në letërsi etj.

Studiuesja shkodrane, Senada Demushi, e cila ka bërë një monografi për poezinë e Marinajt, duke iu referuar vlerësimeve të kritikës, në mes të tjerash veçon: “Kritika bashkëkohore vlerat ideoestetike të vargut të Gjekës i vendos në të njëjtin nivel me ato të Martin Camaj, Frederik Reshpjes, Dritëro Agollit e shumë lirikëve të tjerë, të cilët janë vlerësuar me dhjetëra e qindra herë”^{xi}. Sipas studiuses Demushi: “Poetikën e Marinajt e karakterizon një lirizëm i fuqishëm dhe natyrshmëri e thellë poetike”.^{xi}

Ndërkaq, sipas poetit dhe studiuesit Anton Çefa: “Poezia e Gjekë Marinajt ka ngjyrë të theksuar të ndjenjës, tingull të veçantë, të harmonishëm e melodioz që i japin asaj një ngarkesë të fuqishme ideore emocionale, shpesh befasuese”^{xi}.

Mendimin për poezinë e Marinajt e ka shprehur edhe shkrimtari ynë, Ismail Kadare, të cilin profesor Gjekë Marinaj e ka futur në programet mësimore të kolegjit të Dallasit, duke e hequr nga ato programe romancierin e njohur amerikan, Nathaniel Hawthorne^{xi}. Duke e dhënë vlerësimin e tij në librin e Marinajt “Lutje në ditën e tetë të javës”, ai në mes të tjerash shprehet: “Gjekë Marinaj dallohet ndër poetët më të mirë shqiptarë të kohës dhe kjo do të thotë se ai zë vend midis poetëve më të mirë evropianë”. Sipas Kadaresë, poezia e Marinajt “ka një harmoni të mrekullueshme midis shpirtësisë ballkanase, më e vjetra e kontinentit dhe, asaj planetare”. Me këtë rast Kadare veçon poezinë për kalimin e Akeronit, lumit të skëterrës, atë që ndan jetën nga vdekja, ku ai, djalosh i ri, u arratis nga Shqipëria totalitare më 1990, duke kapërcyer me ‘not’ një lumë që shërbente si kufi”^{xi}.

Një studiuese tjetër nga Shkodra, Mimoza Rexhëvelaj, e cila ka shkruar një libër për letërsinë e diasporës^{xi}, në fokus të studimit të saj e ka vënë edhe veprën poetike të Gjekë Marinajt. Studiuesja në fjalë e cilëson Marinajn si “avokat të lirisë së fjalës që shkel përtej caqeve të vëna nga ish-regjimi komunist në Shqipëri”, por edhe si “poet disident që përshkon disa kufij gjeografikë midis kombeve”. Sipas saj, ai ka sjellë “vlera të padiskutueshme në letërsi, duke ngritur një urë lidhëse mes botës letrare amerikane dhe asaj shqiptare”^{xi}. Në studimin e saj ajo kujton hyrjen triumfale të Gj. Marinajt në poezinë shqipe me vjershën e tij të parë “Kujt” që u kthye në një ngjarje në prag të përmbysjes së sistemit monist. Duke vënë në spikamë disa nga veprat poetike të Marinajt, si: “Mos më ik larg”, “Infinit” etj. dhe poezitë e tij të përfshira në disa antologji amerikane në mes të emrave të dalluar, Rexhëvelaj është e mendimit se “Marinaj është një poet elegant, me shprehje të përpunuara filozofike meditative”^{xi}.

Vlerësime interesante jep edhe studiuesi shqiptar që jeton në diasporë, Fatmir Terziu. Në studimin e tij me titull “Marinaj: Poezia, gjinia më superiore e artit”, në mes të tjerash ai shprehet: “Te Marinaj është shkrirë një pjesë e biografisë së tij në biografinë e qenies. Qenia, e cila paraqitet në vargun e Marinajt nuk është e përcaktuar”. Shprehjen e atdhedashurisë në

poezinë e Marinajt ai e koncepton si formë eksplicite të shprehjes filozofike në universin e së cilës shpaloset pesha e etikës së krijuesit për imazhet, idetë dhe mesazhin e vargut. Sipas Terziut “poezia e Marinajt përbën një metaforë të madhe të jetës dhe të pasjetës, ku gjithherë ngarend për të kuptuar misterin dhe sublimen, tragjiken dhe të zakonshmen etj”. Duke pasur parasysh të gjitha këto, Terziu konstaton se Marinaj me poezinë e tij “i sjell një model të rrallë poetik lexuesit shqiptar dhe letërsisë shqipe”^{xi}.

Studiuesi Ndue Ukaj, si një ndër elementet e rëndësishme të poetikës së Marinajt e veçon aktin imagjativ të bashkëdyzuar me shenja e simbole empirike që, sipas të cilit, tekstit poetik i japin tonalitet të theksuar dhe krijojnë një dinamikë specifike tekstuale. Sipas Ukajt, “lirika e Marinajt bart në vete konceptin e përsosurisë ritmike, një parim organizues simetrik, ku gradacioni poetik dhe aluzionet e vargjeve në përpikëri gërshetohen me harmoninë mes përmbajtjes dhe formës, dimensionit semantik dhe artistik të figurës, të vargut dhe të vjershës në tërësi”^{xi}. Parimi poetik i Marinajt, spikat Ukaj “është i ndërtuar mbi eksperiencën të shëndosha dhe perceptime të shumëfishta për artin dhe njeriun si epiqendër e tij”^{xi}.

Vargut të kontributeve në ndriçimin e vlerave letrare të Gjekë Marinajt i bashkohen edhe Prend Buzhala, Ilir Seci, Kolec Traboini. Agron Tufa, Dhurata Hamzai, ashtu sikurse edhe shumë të tjerë, të cilët e kemi të pamundur t’i përfshijmë brenda një punimi. Sipas Prend Buzhalës, Marinaj “nuk bën pjesë në radhën e poetëve që i “zhgënjën” koha e sotme pas idealeve “të përmbysura” për një shoqëri të “drejtë”, por nuk është as në mesin e “të zhgënjyerve” për përmbysjet e së djeshmes. Ai do ta shquajë, megjithatë, tonin dramatik të ekzistimit e të dhembjes, por edhe tonin përplot vrujime të përsiatjeve e të gërmimeve lirike refleksive në socialen, në realitetin social”^{xi}.

Për Ilir Secin, Marinaj është “një poet i lindur që kërkon me këmbëngulje të dalë nga niveli i krijimtarisë vargëzuese, bazuar në shqisën e lindur e të kultivuar dhe duke thelluar njohjet e tij mbi poezinë e botën në tërësi”^{xi}. Në poezitë e Marinajt, Seci heton sintetizimin e përshkrimit poetik të realitetit, por edhe seleksionimin subjektiv dhe riprodhimin në përmasë arti. Ai i shquan po ashtu dy karakteristika dominuese: substancialitetin e imagjinatës poetike dhe referencialitetin që lidhet me dukuri konkrete, shpesh edhe nga rrafshi jetësor me burimësi sociale.^{xi}

Ndërkaq, shkrimtari anglo-amerikan, Fridrik Turner, kur flet për vlerat e poezisë së Marinajt, ndër të tjera thotë: “Në një botë ku poezia tingëllon si një mplakje, e rraskapitur dhe si një luftëtare në mbrojtje të pikave të fundit të sensibilitetit letrar, Gjekë Marinaj shpërthen në skenë me tërë shkëlqimin e rinisë, me energjinë erotike dhe maturinë e një poeti të pjekur. Ai na tregon në mënyrë që ta shohim botën përtej realizmit magjik, përtej mendjemadhësisë metafizike, madje edhe përtej surrealizmit ngjyrëplotë të Evropës Lindore që tregon akoma agun shpresëplotë të civilizimit human”, është shprehur shkrimtari Turner.

Shkrimtari Wole Souinka, fitues i çmimit “Nobel” në letërsi më 1986, duke i parë karakteristikat e veçanta të poezisë së Marinajt, në mes të tjerash shprehet: “Duket qartë se Gjekë Marinaj është një nga dashamirësit më të sinqertë të letërsisë, me një mendje thithëse si sfungjer. Ai është shembull natyral i poetit tokësor”^{xi}.

Përfundime

Gjekë Marinaj njëri nga poetët e shquar, jo vetëm të diasporës shqiptare në Amerikë, por edhe i poezisë më të re shqipe, ka depërtuar edhe në qarqet letrare të Amerikës dhe të Evropës. Duke u parë edhe nga prizmi i analizës dhe i mendimit kritik të shfaqur për të, mund të konkludojmë se në aspektin e përgjithshëm poezia e Gjekë Marinajt është mjaft autentike, mishërim i invencionit, i mundësive të pafundme e sintezave asociative. Poezi, brenda së cilës shkrihen dijenia e jetës dhe e artit dhe poezi e gërshetimit të nuancave të ndryshme të të shprehurit, e brumosur nga elementet diskursive dhe imagjinatë të frytshme e të paanë.

Ajo është një poezi, në të cilën natyrshëm shpërthen shkëlqimi i rinisë, me atë energjinë erotike dhe maturinë e një poeti të pjekur. Ajo mbetet një lirikë që në vete mbarë konceptin e përsosurisë ritmike dhe një parimi organizues simetrik ku me përpikëri gërshetohen gradacioni poetik dhe aluzionet e vargjeve me harmoninë mes përmbajtjes dhe formës, dimensionit semantik dhe artistik të figurës etj. Poezi e shprehjes së atdhedashurisë që konceptohet si formë eksplicite e shprehjes filozofike, në universin e së cilës shpaloset pesha e etikës së krijuesit për imazhet, idetë dhe mesazhin e vargut. Marinaj na del si një poet elegant, me shprehje të përpunuara filozofike meditative që kultivon një poezi të mishërimit të harmonisë së mrekullueshme midis shpirtësisë ballkanase dhe asaj planetare.

Pa dyshim se Gjekë Marinaj është një poet interesant dhe i rëndësishëm i diasporës shqiptare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Krijimtaria e tij është dhe do të mbetet në fokus të studimit por edhe të përkthimit dhe të depërtimit në letërsinë jo vetëm amerikane, ku tashmë ai është i integruar, por edhe në atë botërore.

Punimin tim po e përmbyll me një mendim të autorit për poezinë, të shfaqur gjatë një interviste dhënë vite më parë shkrimtarit dhe publicistit, Shefqet Dibranit, ku në mes të tjerash deklaroi: “Mua poezia ma ka dhënë atë botë që Zoti ua ka dhënë njerëzve që i besojnë pa kushte Atij. Poezia ma ka drejtuar shpirtin drejt përsosjes, më ka dhënë shpresë, ma ka dhënë besimin se çdo sakrificë për të është më se e vlershme... Te poezia kam gjetur ndihmë kur kam qenë i uritur, kur kam ndier vobekje, tek jetoja faktin kur unë, familja ime dhe i gjithë populli i ndershëm shqiptar po shkrihej në metalurgjinë e kuqe komuniste. Poezia ime më bëri të largohem nga Shqipëria, prej së cilës kur u nisa mora vetëm ca fotografi të familjes, pesë libra me poezi nga autorët tanë dhe një mal me mall të papërshkrueshëm^{xi}.”

Këto mendime të shpërfaqura nga vetë autori janë fakte që tregojnë më së miri lidhjen ose mishërimin e autorit me artin poetik, por edhe me atdheun, leva të forta këto të cilat përbëjnë edhe esencën e jetës njerëzore dhe artistike që të bashkëdyzuara janë çelësi i suksesit në jetë dhe krijimtari të një poeti, në këtë rast të poetit Gjekë Marinaj.

Bibliografia

"Mos më ik larg", Tiranë, 1995.

"Infinit", Teksas, 2000.

"Lutje në ditën e tetë të javës", "Konica", Prishtinë, 2008.

Adnan Mehmeti "Gjekë Marinaj më tepër se poet", New York, 2008.

Adnan Mehmeti "Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë - Autorë dhe vepra", "Adriatic Press, New York, 2020.

Besim Muhadri, LITERATURE 11-12/2019 FILOLOGJIA | Vol. 7 | No. 11-12 | pp. 1-176 | Tetova | 2019, ISSN 1857-8535).

Besim Muhadri, *Përmasa e krijimit*, "Bogdani & Adriatic Press", Prizren-Nju Jork, 2013.

Dashnor Kaloçi *Si e futa Kadarenë në programet mësimore të kolegjit të Dallasit, pasi hoqa romancierin e njohur amerikan Nathaniel Hawthorne*, Intervistë me Gjekë Marinajn, Gazeta "Shqip", Nr. 243, Nëntor 2006.

Kujtim Morina, *Protonizmi si veçori e Gjekë Marinajt*, Agjensioni Flori press, 27 maj 2012.

Mimoza Rexhëvelaj, *Vështrim mbi poezinë e diasporës*, "Fiorentina", Shkodër, 2013.

Fatmir Terziu, *Poezia, gjinia më superiore e artit*, Fjala e lirë, 5 mars 2008.

Mujo Buçpapaj, *E veçanta e poezisë së Gjekë Marinajt*, Rilindja Demokratike, 29 korrik 2008.

Senada Demushi (Delaj): *Shtigjeve letrare të Gjekë Marinajt*, (monografi), Botimet Nacional, Tiranë, 2016.

Ndue Ukaj, Logosi i fjalës poetike, *Lutje në ditën e tetë të javës*, parathënie e librit poetik të Gjekë Marinajt "Në ditën e tetë të javës", "Faik Konica", Prishtinë, 2008.

Prend Buzhala, "Teorema e jetës në pafundësi", gazeta "Rilindja, Prishtinë dhe ribotuar në librin e Adnan Mehmetit "Gjekë Marinaj më shumë se poet", "Adriatic Press", New York, 2008.

Prend Buzhala, *Sfida e paskrijimit*, "Të folurit e kryqëzimit shqip", SHKK "Anton Pashku", Prishtinë, 2011.

Ilir Seci, Efekte të kontrasteve poetike, "Illyria" nr. 1261, Korrik, SHB "LSHA", 1995 dhe "Marinaj Publishing", 2000.

Gazeta Tema, 22 dhjetor 2008, me rastin e akordimit të çmimit "Pjetër Arbnori" për Gjekë Marinajn. Cituar sipas Mujo Buçpapës.

Shefqet Dibrani, Te poezia kam gjetur ndihmë, Intervistë me Gjekë Marinajn, "Bota Sot", dhjetor 2003.

Kolec Traboini: *Shënime për dy vëllime poetike të Gjekë Marinajt*, shkodraonline.com, 12 prill 2001.

Dhurata Hamzai, *Poezia e Gjekë Marinajt si fletë bible*, gazeta Tema, 22.05.2008.

Mikel Gojani, *Lirizmi poetik i Gjekë Marinajt*, Gazeta "Shqip", viti IV, Nr. 1777 (1188), Qershor 2009.